

Themelohet Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore në Preshevë

Publikuar: Sot, më 17 tetor 2010



Preshevë, 17 tetor – Të shtunën, në Preshevë, është themeluar Shoqata për trashëgimi dhe krijimtari kulturore, me ç`rast Xhemaledin Salihu, emërohet kryetar i saj.

Në Kuvendin themelues të kësaj shoqate, përveç intelektualëve me profileve të ndryshme nga Lugina e Preshevës, morën pjesë edhe intelektualë nga ky rajon, që tashmë jetojnë dhe veprojnë në Kosovë. U tha se ky rajon është një arë me shumë vlera, e pa gjuarmuar, derisa të tjerët potencuan se mbrojtja e identitetit kombëtar bëhet përmes ruajtjes së vlerave natyrore e kulturore të këtij rajoni.

Në këtë kuvend është miratuar edhe statuti i shoqatës për trashëgimi dhe krijimtari kulturore. Objektivat e shoqatës janë

hulumtimi, evidentimi, kultivimi, mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, si dhe hulumtimi, kultivimi dhe zhvillimi i krijimtarisë kulturore.

Po ashtu, në kuvendin zgjedhorë u bë edhe zgjedhja e organeve të shoqatës. Kryetar i saj u emërua, Xhemaledin Salihu, zv/kryetar, Xhait Ramadani dhe Ismet Bajrami, ndërsa sekretar i shoqatës u emërua, Feti Shaipi. Selia e Shoqatës për trashëgimi dhe krijimtari kulturore gjendet në Shtëpinë e Kulturës “Abdulla Krashnica”, në Preshevë.

Komentet(0)

NE PRESHEVE THEMELOHET SHOQATA PER TRASHEGIMI DHE KRIJIMTARI KULTURORE

Postuar nga [RadioPresheva](#) më 25/09/2010 në kategorinë [Kulturë](#), [Lajmet](#) | [0 Komente](#)



Këshilli nismëtar i Shoqatës

Dje, më 23 shtator 2020, në sallën e leximit të Bibliotekës “Mehmet Jusufi” në Preshevë u mbajt takimi i parë i Këshillit Nismëtar i kësaj Shoqate, ku ishin të pranishëm : Xhemaledin Salihu, Xhahit Ramadani, Demush Berisha, Sadete Presheva, Havçe Hasani, Feti Shaipi, Abedin Selimi, Abdurrahman Zylfiu, Agron Boriçi, Ismet Bajrami, Zeqirja Fazliu dhe Naser Kamberi.

Kryesuesi i këtij tubimi Xhemaledin Salihu elaboroi dhe foli për nismën e themelimit të Shoqatës, karakterin, qëllimet, detyrat, degët, emrin, selinë, sektorët, anëtarimin, qeverisjen, mjetet dhe regjistrimin e kësaj Shoqate.

Në diskutim morën pjesë : Zeqirja Fazliu, Havçe Hasani, Agron Boriçi, Ismet Bajrami, Feti Shaipi, Demush Berisha, Sadri Qazimi, Abdurrahman Zylfiu, Xhahit Ramadani nga Bujanoci, Naser Kamberi dhe profesori i nderuar dhe i respektuar Mustafë Selimi, i cili prezantoi dhe përshëndeti nismën e themelimit të Shoqatës.

Thuajse të gjithë diskutantët u pajtuan dhe e vlerësuan themelimin e Shoqatës si nismë të mbarë, të qëlluar, por pak të vonuar. Ata poashtu diskutuan shumë çështje me rëndësi për punën dhe veprimtarinë e Shoqatës.

Në fund të takimit u aprovuan disa përfundime : të gjithë të pranishmitë njëzërit u deklaruan për themelimin e Shoqatës, pati mendime dhe propozime të ndryshme lidhur me emrin dhe veprimtarinë e Shoqatës, shprehën vullnetin të angazhohen në mbarëvajtjen

e punës së Shoqatës, por edhe në angazhimin e të gjithëve që në gjirin e Shoqatës të angazhohen profile, ekspertë të lëmive të ndryshme si dhe angazhimin e anëtarëve të rinjë, që nesër do ta bartin punën e kësaj Shoqate, se duhet gjithësesi mbështetja morale, sidomos ajo materiale e strukturave dhe buxhetit komunal.

Dhe në fund u themelua Grupi punues në përbërje : Xhemaledin Salihu, Xhahit Ramadani, Feti Shaiqi, Ismet Bajrami dhe Zeqirja Fazliu, duke mos i anashkalur mendimet dhe diskutimet e të pranishmëve, i cili do ta hartojë Statutin, Programin dhe do ta përgatisë Kuvendin Themelues të Shoqatës.

Poashtu do të nderohen dhe do të merren parasysh edhe propozimet, sygjerimet e të interesuarëve që kanë vullnet të japin kontribut në punën e Shoqatës.

Preshevë, më 24 shtator 2010